

## 1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më pak se 17 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 për femrat.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare, dhe mesatarja [përfundimtare e të gjitha viteve për lëndët Matematikë, Fizikë dhe Kimi të jetë mbi 8 (tetë).
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
  - a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
  - b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
  - c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, skualifikohet.

## 2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Institucionet e Larta Arsimore Ushtarake të Turqisë.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **Aneksi A**.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listën e notave.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.



<b>Max</b>	<b>59"</b>	<b>100</b>								
------------	------------	------------	--	--	--	--	--	--	--	--

### FEMRA

NORM	Vrapim 800 m		Kërcim së gjati nga vendi		Palosje barku (1 minute)		Qendrim ne hekur		Hedhja e topit te basketbollit	
	Sas	Pike	CM	Pike	Sas	Pike	Koha	Pike	Sas	Pike
<b>Min</b>	<b>4.20-4.30</b>	<b>10</b>	<b>150-</b>	<b>10</b>	<b>15-18</b>	<b>10</b>	<b>25-27</b>	<b>10</b>	<b>7-8</b>	<b>10</b>
	4.19-4.10	20	155-	20	19-22	20	28-30	20	9-10	20
	4.09-4.00	30	160-	30	23-26	30	31-33	30	11-12	30
	3.59-3.50	40	165-	40	27-30	40	34-35	40	13-14	40
	3.49-3.40	50	170-	50	31-34	50	36-37	50	15-16	50
	3.39-3.30	60	175-	60	35-38	60	38-39	60	17-18	60
	3.29-3.20	70	180-	70	39-42	70	40-41	70	19-20	70
	3.19-3.10	80	185-	80	43-46	80	42-43	80	21	80
	3.09-3.00	90	190-	90	47-49	90	44-45	90	22	90
<b>Max</b>	<b>2.59 dhe -</b>	<b>100</b>	<b>195+</b>	<b>100</b>	<b>50+</b>	<b>100</b>	<b>46+</b>	<b>100</b>	<b>23+</b>	<b>100</b>